



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 46/1 Prot.

Tiranë, më 10.01.2018

**V E N D I M**

**Nr. 4, Datë 10.01.2018**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa numër 151, datë 13.11.2017, e bërë nga S. V., kundër Bashkisë Shkodër, në të cilën pretendon diskriminim *për shkak gjendjes ekonomike*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

S. V. sqaron se familja e tij, është në gjendje jo të mirë ekonomike. Të ardhurat familjare janë ndihma ekonomike që marrin nga ana e Bashkisë Shkodër dhe pagesa e invaliditetit të tij. Për shkak të pamundësisë ekonomike, ai nuk ka mundur të paguajë qiranë e shtëpisë ku ndodhet aktualisht dhe rrezikon të dalë nga banesa. Sipas tij, i është drejtuar disa herë Bashkisë Shkodër për t’i siguruar një mundësi strehimi, por nuk është marrë asnjë masë prej tyre.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se ankuesi nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionerit informacion të mjaftueshëm për të vijuar me shqyrtimin e ankesës, lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues nga ana e Bashkisë Shkodër. Në këto kushte, Komisioneri iu drejtua ankuesit me anë të shkresës nr. 1115/1 prot., datë 21.11.2017, ku për efekt të shqyrtimit të ankesës së depozituar nga ana e tij, i kërkohet informacion mbi kohën kur ka aplikuar për banesë, si dhe kopje të shkresave të shkëmbyera ndërmjet tij dhe Bashkisë Shkodër.

Për sa më sipër, shkresa drejtuar ankuesit, u kthye nga Posta Shqiptare, për shkak se subjekti ishte larguar nga banesa. Në këto kushte, strukturat përgjegjëse të KMD-së kontaktuan<sup>1</sup> me ankuesin në telefon dhe e drejtuan për të marrë një kopje të shkresës pranë Zyrës Rajonale në

<sup>1</sup> Më datë 06.12.2017, iu kërkua të vinte në dispozicion informacionin e cituar në shkresë.

Shkodër të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pasi iu vu në dispozicion shkresa e KMD-së me nr. 1115/1 prot., datë 21.11.2017, ankuesi nuk e dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

**Në këto kushte, pas analizimit të ankesës nr. 151, datë 13.11.2017, Komisioneri konstatoi se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” përcaktohet një listë joshterruese shkaqesh diskriminimi, ku në çdo rast pala ankuese duhet të japë argumentimet përkatëse, të cilat të krijojnë një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pabarabartë dhe disfavorizues, që ajo pretendon se është ndërmarrë ndaj vajzës së saj, me këtë shkak diskriminimi.

Në këto kushte, në mungesë të provave të kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të dhënë informacion rreth kohës kur ka aplikuar për mundësi strehimi dhe për të vënë në dispozicion të KMD-së, korresponcën shkresore të mbajtur me Bashkinë Shkodër, nuk është e mundur që të iniciohet procesi i hetimit administrativ.

Për sa më sipër, nga pikëpamja formale, Komisioneri vlerësoi se ankesa nr. 151, datë 13.11.2017, e S. V. nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Në nenin 33, pika 4, gërma ç), parashikohet se :

*“Ankesa nuk pranohet nëse:*

*a).....*

*b).....*

*c).....*

*ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;*

Për sa më sipër, duke analizuar në tërësi ankesën nr. 151, datë 13.11.2017, e S. V., Komisioneri gjykoi se për rastin konkret nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 12, 20, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç) të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

- 1.** Mospranimin e ankesës nr. 151, datë 13.11.2017, e S. V., pasi ankesa nuk plotëson kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- 2.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**KOMISIONERI**

---

**Irma BARAKU**

(Shkaku: Gjendja ekonomike)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)